

	<b>REPUBLIKA E KOSOVËS</b> REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA <b>KOMUNA E RAHOVECIT</b> OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

<b>Për:</b>	Operatori Ekonomik: <b>Bajram Ha. Gashi B.I.</b> me adresë në <b>Suharekë</b> <b>Operatorëve Ekonomik</b> <b>Të gjitha palëve të interesuar</b>
<b>Nga:</b>	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
<b>Lënda:</b>	<b>VENDIM</b> për Rishqyrtim të Kërkesës
<b>Datë:</b>	<b>23.06.2026</b>

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 63 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, sa i përket **Kërkesës për Rishqyrtim** të datës: **22.06.2026**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Bajram Ha. Gashi B.I.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Rrethimi i oborreve të shkollave**, me Numër të prokurimit: **623-26-2494-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-013-5-2-1**, nxjerr:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **Bajram Ha. Gashi B.I.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Rrethimi i oborreve të shkollave**, me Numër të prokurimit: **623-26-2494-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-013-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **16.06.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit, me Numër të prokurimit: **623-26-2494-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-013-5-2-1**
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

## A r s y e t i m

Operatori Ekonomik: **Bajram Ha. Gashi B.I.** me adresë në **Suharekë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Rrethimi i oborreve të shkollave**, me Numër të prokurimit: **623-26-2494-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-26-013-5-2-1**, kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK-së, të datës: **16.06.2026**, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **22.06.2026**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

### **Baza Ligjore për Refuzim të Kërkesës**

**Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar**, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik

Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit **B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar**, ku kemi cekur:

**Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:**

**Ju njoftoj se ju si Operator Ekonomik nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):**

**Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:**

**Kërkesa 5: Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me këto Certifikata ISO**

**- ISO 45001:2018 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë);**

**- ISO 9001:2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë);**

**- ISO 14001:2015 (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit);**

**Dëshmia 5: Certifikatat Kopje dhe me Validitet;**

**Sqarimet janë si në vijim:**

Autoriteti Kontraktues ka verifikuar validitetin e certifikatave **ISO 45001:2018, ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015** të paraqitura nga Operatori Ekonomik, në faqen zyrtare të organit certifikues. Gjatë këtij verifikimi është konstatuar se, ndryshe nga operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit, te të cilët për të tri certifikatat figuron qartë statusi "**VALID**", për certifikatat e paraqitura nga Operatori Ekonomik **Bajram Ha. Gashi B.I. / N.N.P. "BG-ing"** në rubrikën "**Validity**" nuk figuron asnjë status për asnjërën prej tyre. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues nuk ka mundur të verifikojë dhe të konstatojë validitetin e certifikatave të paraqitura, ashtu siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit, ku është përcaktuar se **ISO 45001:2018, ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015 duhet të paraqiten në kopje dhe me validitet.**

## Verifikimi i certifikatës për Bajram Ha. Gashi B.I.



Company name: Bajram Ha. Gashi B.I. Emri Tregtar: N.N.P. " BG-ing " Numri unik identifikues: 811038498

Address: Dubravë, Suharekë, Kosovë.

Standard: ISO 9001:2015

First Issue: 13/03/2023

Modification no and date: Recertification/ Ricertifikimi 13/03/2026

Expiry date: 12/03/2029

Number of certificate: AQS/Q/163592026

Scop: Projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje e rrugëve, infrastrukturës rrugore dhe veprave civile dhe industriale, ujësjellësa, kanalizime, diga, bonifikime, sisteme kullimi. Restaurime të të gjitha sistemeve inxhinierike. Punime të inxhinierisë ambientale (prodhim, zbatim). Tregtimi i lëndëve të para dhe materialeve për ndërtim dhe rikonstruksioni i objekteve civile dhe industriale.

Scop: Design, construction and maintenance of roads, road infrastructure and civil and industrial works, waterworks, sewers, dams, land improvement, drainage systems. Restorations of all engineering systems. Environmental engineering works (production, implementation). Marketing of raw materials and materials for construction and reconstruction of civil and industrial objects.

Validity:

## Verifikimi i certifikatës për NPN Euroing SH.P.K.



Company name: NPN Euroing SH.P.K Numri Unik Identifikues: 811302281

Address: Xërxë, p.n. Rahovec, Prishtinë, Kosovë.

Standard: EN-ISO 9001:2015

First Issue: 27/09/2023

Modification no and date:

Expiry date: 26/09/2026

Number of certificate: AQS/Q/109152023

Scop: Projektimi, mbikqyrja dhe menaxhimi i projekteve, ndërtimi, mirëmbajtja dhe konstruksioni i objekteve civile dhe industriale (autostrada, aeroporte, rruge dhe infrastrukturë rrugore, objekte sportive, ujësjelles, kanalizime, instalime elektrike, instalime makinerike, rrënimet e objekteve, diga, mbrojtje lumore dhe bonifikime, sisteme kullimi e vaditje, restaurime objekte banimi, shkolla, spitale, mure betonarme, ura, shkallë etj. Prodhimi i betonit të gatshëm për ndërtim, konstruksione metalike, hidroizolime, termoizolime, etj...

Scop: Projection, supervision and management of project, construction, maintenance and construction of civil and industrial objects (highways, airports, roads and road infrastructure, sports facilities, water supply, sewerage, electrical installations, mechanical installations, ravages of buildings, dams, river embankments and land improvement, drainage and systems of irrigation, restorations of residential buildings, schools, hospitals, concrete walls, bridges, stairs, etc. Production of concrete prepared for construction, metallic constructions, hydro isolations, thermal insulations, etc..

Validity: VALID

**Me datë: 09.06.2026, kemi kërkuar me formular: B47 Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit:**

**Kapaciteti teknik dhe profesional:**

**Kërkesa 6: Operatori Ekonomik duhet te posedoje mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë te domosdoshme për realizimin e projektit, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës ne Aneksin 9 te Dosjes se Tenderit;**

**Dëshmia 6: Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera Operatori Ekonomik duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj.).**

**Vëmendje!**

**Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj**

**kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete origjinale ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit;**

**1. Kamionet me lift me peshë maksimale 840 kg;**

**Në ofertën tuaj të dorëzuar, mungon pajisja e lartcekur, ju si OE nuk keni prezantuar librezën e regjistrimit si dhe as marrëveshjen mbi huazimin e automjetit të lartcekur;**

**Ne si AK: Komuna e Rahovecit, kërkojmë nga ana juaj të na dorëzoni informacionet qe mungojnë;**

**Ju si Operator Ekonomik, në sqarime/pas hapjes, keni dorëzuar Marrëveshje mbi dhënie në shfrytëzim të mjeteve të punës, e cila marrëveshje është e pa pranueshme për ne si AK, pasi që bie ndesh me Nenin 72 pika 3 i LPP – së i cili e përcakton si në vijim: Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet *ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, marrëveshje mbi dhënie në shfrytëzim të mjeteve të punës nuk verifikohet në mënyrë objektive,***

**Po ashtu në Njoftim për Kontratë/Dosje e tenderit kemi kërkuar: Kamionet me lift me peshë maksimale 840 kg;**

*Gjatë sqarimeve dokumenti i dorëzuar nga ana juaj është:*

A	Shifra e regjistrimit, lloji përkatës, Regjistrimi number:	04-955-FE
I	Data e regjistrimit, Data e përkatëse, Registration date:	08.07.2025
C	Të dhënat personale, Person's data:	
C.2	Personi i caktuar, Person's name, Owner of the vehicle:	
C.2.1	Mbiemri i emrit i historit, Surname or business name:	Limaj
C.2.2	Emri, Emri, Name:	Dan
C.2.3	Adresa, Adresa, Address:	RR, BRIGADA 121, SHHAREKË
B	Data e regjistrimit të punës, Data e fillimit të regjistrimit:	02.02.2007
D	Automjeti, Bërësi, Vehicle:	
D.1	Produktuesi, Producenti, Make:	Renault
D.2	Tipi, Tipi, Type:	MASTER
D3	Prodhuesi i komercial, Komercializuesi i tregut, Commercial dealer (code):	
E	Shifra identifikuese e llojit/motit, Identifikuesi i llojit/motit, Vehicle Identification Number (VIN):	VF6FCVH536R06441
S	Vendi i prodhimit, Vendi i prodhimit, Year of production:	2007
S	Sipërfaqja e sipërfaqes, Lartësia e sipërfaqes, Surface area:	2
S.1	Numri i llojit, Lloji i sipërfaqes, Number of parts:	
S.2	Shifra e kodit për qendrën, Tipi i sipërfaqes, Number of the code:	
Q	Kapaciteti i punës, Peshë e punës (në kW), Peshë e punës (në kW), Power (Weight Power (in kW)):	
F	Peshë, Peshë, Weight:	3500
F1	Peshë e punës, Peshë e punës, Maximum permitted load:	530
G	Peshë e automjetit, Peshë e punës, Mass of the vehicle:	2970
K	Hierologjimi, Niveli i punës, Type of approval:	
P	Motori, Motor, Engine:	
P1	Kapaciteti (në cm3), Kapaciteti (në cm3), Capacity (in cm3):	2483
P2	Funksionimi maksimal në (në kW), Maksimumi i punës (në kW), Maximum net power (in kW):	73,00
P3	Lloji i karburantit, Lloji i karburantit, Type of fuel (in kW):	Dizel
R	Ngjyra e shtetit, Ngjyra e shtetit, Color of the vehicle:	E BARDHË
ZA	Niveli i punës, Niveli i punës, Level of the vehicle:	FURGON SPECIAL ME KORPË me 4 drryer

**Ku në librezë për këtë pajisje lexon: **FURGON SPECIAL ME KORPË me 4 drryer**, dhe jo **Kamionet me lift me peshë maksimale 840 kg**, sipas kërkesës së AK-së;**

## Pretendimi Nr. 1 Ankimor:

### Pretendimi ankimor 1- Arsyetimi jo ligjor nga AK- Komuna Rahovec lidhur me validitetin e certifikatave: ISO 45001:2018; 9001:2015 dhe 14001:2015

Lidhur me këto kërkesa ju në vendimin e dt 16.06.2026, keni deklaruar si vijon:

dosjen e tenderit. Iste kërqarungo ju njortojme se jeni enantimuar per shkak te arsyeve ne vijim.

#### **ARSYETIM:**

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit tek Seksioni II, Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

#### **Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale:**

**Kërkesa 5:** Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me këto Certifikata ISO

- **ISO 45001:2018** (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë);

- **ISO 9001:2015** (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë);

- **ISO 14001:2015** (Certifikata për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit);

#### **Dëshmia 5: Certifikatat Kopje dhe me Validitet:**

#### **Sqarimet janë si në vijim:**

Autoriteti Kontraktues ka verifikuar validitetin e certifikatave **ISO 45001:2018, ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015** të paraqitura nga Operatori Ekonomik, në faqen zyrtare të organit certifikues. Gjatë këtij verifikimi është konstatuar se, ndryshe nga operatorët e tjerë ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit, te të cilët për të tri certifikatat figuron qartë statusi "VALID", për certifikatat e paraqitura nga Operatori Ekonomik **Bajram Ha. Gashi B.L. / N.N.P. "BG-Ing"** në rubrikën "Validity" nuk figuron asnjë status për asnjërën prej tyre. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues nuk ka mundur të verifikojë dhe të konstatojë validitetin e certifikatave të paraqitura, ashtu siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit, ku është përcaktuar se **ISO 45001:2018, ISO 9001:2015 dhe ISO 14001:2015 duhet të paraqiten në kopje dhe me validitet.**

Ne si OE kemi dorëzuar dëshmi kopjet e certifikatave në të cilat qartë është shprehur afati i vlefshmërisë.

Përkatësisht në dokumentin e dorëzuar në dosjen e tenderit, të titulluar "13. 13.ISO STANDARDET BG" janë të vendosura certifikatat e ISO standardeve që ne si kompani

mbajme.

Më konkretisht ne kemi dhënë dëshmi të mjaftueshme se:

- Certifikata ISO 45001-2018 është valide deri më 12.03.2029
- Certifikata ISO 9001-2015 është valide deri më 12.03.2029 dhe
- Certifikata ISO 14001-2015 është valide deri më 12.03.2029

Pra sic shihet haptas është plotësuar ky kusht i tenderit "**dëshmia 5: certifikatat kopje dhe me validitet**" pasi që ne kemi dorëzuar kopjet e certifikatave në fjalë **VALIDE**.

**Fakti se ju si AK nuk keni qenë në gjendje që "ta shihni" validitetin e tyre edhe në web faqen e kompanisë që kanë bërë certifikimin NUK i bën certifikatat tona jovalide!**

**Juve si AK është dashur të ju mjaftojë fakti se në vetë kopjen e certifikatës së ofruar, është paraqitur shprehur VALIDITETI deri në vitin 2029.** Por nëse kërkohet verifikim shtesë, atëherë keni mundur që të kontaktoni me kompaninë në fjalë dhe në mënyrë zyrtare të kërkonit përgjigje dhe dëshmi prej tyre lidhur me validitetin e certifikatave, e jo të merrni veprime e vendime të tilla arbitrare pa kurrëfarë baze ligjore vetëm pse nga një kërkim juaj jorprofesional në internet nuk ju paska rezultuar në përgjigjen që keni pritur. Kjo dëshmon se sa të anshëm e jo-objektiv jeni, e sa në kundërshtim me parimet e LPP është vendimi juaj.

Provë 1. Kopjet e certifikatave **VALIDE** te dorezuara:

### **Përgjigje në Pretendimi Nr. 1 Ankimor:**

Autoriteti Kontraktues ka për detyrë të vlerësojë përgjegjshmërinë e ofertave bazuar në dëshmi reale dhe valide. Certifikatat ISO 9001, 14001 dhe 45001 janë të varura nga auditimet vjetore të mbikëqyrjes. Fakti që në kopjen fizike shënohet viti 2029, nuk e bën atë automatikisht valide nëse në regjistrin zyrtar të organit certifikues (*i cili është burimi i vetëm i të vërtetës për këto certifikata*) rubrika "Validity" **është e zbrazët**. Mungesa e statusit "VALID" nënkupton që certifikata NUK është aktive në momentin e dorëzimit të ofertës.

AK ka verifikuar të gjithë operatorët në të njëjtën formë profesionale përmes ueb-faqeve zyrtare të organeve certifikuese. Te të gjithë operatorët e tjerë statusi figuron qartë "VALID", ndërsa te OE ankues statusi nuk ekziston. Pranimi i një certifikate me status të paverifikueshëm në burim do të përbënte shkelje të rëndë të Nenit 7 të LPP-së.

Sipas Nenit 72 të LPP-së, AK nuk mund të kërkojë dëshmi apo të hetojë në mënyrë zyrtare pranë palëve të treta për të përmirësuar apo plotësuar një mangësi substanciale të ofertës së një OE-je. Barra për të mbajtur certifikatat aktive dhe të verifikueshme në regjistrat publikë bie ekskluzivisht mbi OE-në ankues dhe jo mbi AK-në.

Vendimi i AK-së për eliminim nuk është arbitrar, por është i bazuar strikt në dështimin e OE-së për të provuar vlefshmërinë e certifikatave në kohë reale.

Pretendimi juaj në këtë **pikë është i pabazuara;**

## Pretendimi Nr. 2 Ankimor:

### Pretendimi ankimor 2: Arsyejtimi jo- ligjor i dhënë nga ju si Ak lidhur me kapacitetin teknik e profesional përkatësisht me kërkesën nr 6

Lidhur me këto kërkesa ju në vendimin e dt 16.06.2026, keni deklaruar si vijon:

Dëshmia 6: Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet të jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera Operatori Ekonomik duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (faturë, DUD etj).

Vërejtje:

Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulesur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete origjinale ne mes te qiramarrësit dhe qiramarrësit;

1. Kamionet me lart me peshë maksimale 840 kg;

Në ofertën tuaj të dorëzuar, mungon pajisja e lartcekur, ju si OE nuk keni prezantuar librezën e regjistrimit si dhe as marrëveshjen mbi huazimin e automjetit të lartcekur;

Ne si AK: Komuna e Rahovecit, kërkojmë nga ana juaj të na dorëzoni informacionet qe mungojnë;

Ju si Operator Ekonomik, në sqarime/pas hapjes, keni dorëzuar Marrëveshje mbi dhënie në shfrytëzim të mjeteve të punës, e cila marrëveshje është e pa pranueshme për ne si AK, pasi që bie ndesh me Nenin 72 pika 3 i LPP – së i cili e përcakton si në vijim: *Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistencë e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive, marrëveshje mbi dhënie në shfrytëzim të mjeteve të punës nuk verifikohet në mënyrë objektive,*

Po ashtu në Njoftim për Kontratë/Dosje e tenderit kemi kërkuar: Kamionet me lart me peshë maksimale 840 kg;

Ne si OE, në datën dorëzimit të tenderit kemi dorëzuar dëshmi të mjaftueshme lidhur me faktin se mjeti në fjalë me targa 04-955-PE, e kemi në dispozicion përmes marrëveshjes së huazimit të mjeteve, detajet tjera që janë ngarkuar teknikisht gabimisht, dmth s'janë ngarkuar në mënyrë të rregullt në datën e dorëzimit të ofertës, i kemi plotësuar tërësisht përmes përgjigjes sonë të datës 10.06.2026 në kërkesën tuaj për sqarim të tenderit të kërkuar më datën 09.06.2026.

Pra ne kemi plotësuar dokumentacionin për mjet që dëshmohet plotësisht në mënyrë objektive se ka EKZISTUAR në listë para hapjes së tenderëve pikërisht ashtu siç e kërkon ligji. Prové: lista e pajisjeve për tenderin në fjalë që ndodhet në ofertën tonë të dorëzuar në këtë procedurë me titull "28.Aneksi 9. Pajisjet-Lista", është plotësisht në pajtueshmëri me kërkesat e LPP neni 72!

Por, juve si AK nuk ju ka mjaftuar, pasi që që nga fillimi ju jeni treguar tendencioz dhe diskriminues ndaj nesh, duke filluar edhe me letren standarde kërkesë për sqarim të cilën e keni dërguar më 09.06.2026 na keni dhënë 2 ditë kohe për kthim përgjigjs duke cekur se afati i fundit për dorëzim të përgjigjes është 10.06.2026, faktikisht na është dhënë 1 ditë pune afat që nuk ekziston në LPP. Ky është diskriminim i hapur ndaj nesh, të cilin e kemi hasur edhe në të kaluarën në procedura të tjera të prokurimit publik nga ju si AK. Kjo sjellje juaja, është shkelje e rëndë e ligjit për prokurim publik e dekurajim i pjesëmarrjes në aktivitete të prokurimit. Andaj kërkojmë nga ju që menjëherë të ndërpritet ky lloj trajtimi diskriminues ndaj nesh, automatikisht

nëse një palë interesi me çdo kusht tentohet të eliminohet duke shpikur lloj lloj arsyesimesh jo ligjore, nënkuptohet favorizim ndaj palës apo palëve të tjera, dhe kjo është në kundërshtim me parimet e LPP.

Prové: Aneks 9 lista e pajisjeve dorezuar me oferte

## **Përgjigje në Pretendimi Nr. 2 Ankimor:**

### **Në kundërshtim me Neni 72 të LPP-së (Dorëzimi i Marrëveshjes pas hapjes)**

Gjatë fazës së sqarimeve pas hapjes së tenderit, Ju si Operator Ekonomik keni dorëzuar një "Marrëveshje mbi dhënien në shfrytëzim të mjeteve të punës". Kjo marrëveshje është e papranueshme për Autoritetin Kontraktues pasi bie në ndesh të drejtpërdrejtë me **Nenin 72, pika 3 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP)**, i cili përcakton qartë:

*"Sigurimi i informacionit që mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive."*

**Në pretendimin e juaj** keni cekur: *s'janë ngarkuar në mënyrë të rregullt në datën e dorëzimit të ofertës, i kemi plotësuar tërësisht përmes përgjigjes sonë të datës 10.06.2026 në kërkesë për sqarim të tenderit të kërkuar me datën: 09.06.2026.*

Marrëveshja e dorëzuar prej jush mbi dhënien në shfrytëzim të mjeteve të punës **nuk mund të verifikohet në mënyrë objektive** si dokument ekzistues para datës së hapjes. Ky veprim vlerësohet si tentativë për plotësim dhe ndryshim substancial të ofertës fillon pas hapjes së tenderit, gjë që ndaloher reptehtësisht nga LPP-ja.

### **Mospërputhja Radikale Teknike e Mjetit (Kamionet me Lift vs. Furgon me Korpë)**

Në Njoftimin për Kontratë dhe në Dosjen e Tenderit, është kërkuar në mënyrë specifike: "**Kamionet me lift me peshë maksimale 840 kg**" (*mjet i destinuar për transport dhe ngarkim-shkarkim mallrash*).

**Në kë kërkesë për rishqyrtim**, të dorëzuar nga ana juaj, **me datë: 07.05.2026, keni kërkuar: Pretendimi Lidhur me pajisjen: Kamionet me lift me peshë maksimale 840kg: Në Aneksin 9 është kërkuar "Kamion me lift me peshë maksimale 840 kg". Konsiderojmë se ky formulim është kufizues dhe jo proporcional me objektin e kontratës, pasi përcaktimi i një kapaciteti maksimal prej 840 kg mund të përjashtojë operatorë ekonomikë që posedojnë pajisje ekuivalente, të cilat teknikisht janë të afta ta kryejnë funksionin e kërkuar në mënyrë të barabartë ose madje edhe më efikase.**

Nga verifikimi i dokumentacionit tuaj (**Librezës së automjetit**), rezulton se mjeti i ofruar nga ju është specifikuar si: "**FURGON SPECIAL ME KORPË me 4 dyer**".

Një furgon special me korpë, është një mjet me natyrë, strukturë, funksion dhe destinim krejtësisht tjetër nga kamioni me lift i kërkuar, Libreza e automjetit tuaj vërteton zyrtarisht se mjeti i ofruar **nuk i përgjigjet kërkesës teknike të AK-së**. Ofrimi i një mjeti me 4 dyer me korpë në vend të kamionit me lift përbën devijim madhor nga lënda e kontratës.

Pretendimi juaj në këtë **pikë është i pabazuara;**

## Pretendimi Nr. 3 Ankimor:

### Pretendimi ankimor 3.

Pas publikimit të vendimit mbi rezultatin e aktivitetit të prokurimit, ne si OE pjesëmarrës në këtë procedurë të prokurimit, siç u tha më sipër, kemi kërkuar qasje në dokumentet – ofertën e tërësishme të OE pjesëmarrës, mirëpo na është dhënë qasje e pjesëshme, për OE e rekomanduar për kontratë, oferta e të cilit ka çmim më të lartë sesa oferta jonë- çmim më i pafavorshëm për AK.

Përkatësisht na është dhënë qasje në këto dokumente:

- 1.Çertifikata e Biznesit dhe TVSH\_Euroi
- 2.Profili i Kompanisë\_Euroing
- 3.Qarkullimi me ATK dhe Raportet e At
- 4. Aneksi 2. Deklarata nën betim
- 5. Aneksi 3. Kërkesa për sekret afarist
- 6. Lista e Projekteve të Përfunduara\_Re
- 7. Deklarata per specifikime teknike
- 8. Deklarata per vegla dhe pajisje teknil
- 9.Aneksi 6.1
- 10.1. Lista e Punëtorëve\_Kontrata Pjesa
- 10.Lista e Punëtorëve\_Kontrata
- 36761c54-a84f-46ba-a782-eb90e0e37ef
- Garancioni (1)
- Përshkrimi i Çmimeve - Rrethimi i obo

Ndërsa mungon dokumentacioni lidhur me ISO standarde, aftësitë teknike e profesionale (punëtorët dhe makineria/ pajisjet), duke ndjekur kërkesën e OL në fjalë për sekret afarist.

Ju, AK –Komuna Rahovec, keni vepruar në kundërshtim me LPP, pasi që nuk keni përgatitur versionin e pastruar të dokumentacionit për të cilin na keni mohuar qasje.

Kjo kërkesë është e definuar nga paragrafi 4 i nenit 11, të LPP-së përcakton se:

*“Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e “pastruar” të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versioni i pastruar i bashkëngjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste”.*

E drejta për qasje në dokumente publike është e drejtë bazike madje e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e që sipas nenit 41 përkufizohet si vijon:

1. *Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike.*
2. *Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.*

Neni 97 i Rregullores për prokurim publik nr. 001/2022, pika C), mos ofrimin e qasjes e klasifikon si shkelje të rëndë të ligjit për prokurim publik.

*c) Mos lejimi dhe/ose neglizhimi i qasjes në dokumenteve zyrtare sipas kërkesës me shkrim të parashtruar nga pala e interesit kur një qasje e tillë e kërkuar është në përputhje me nenin 10 dhe 11 të Ligjit të Prokurimit Publik.*

Qasja e plotë në dokumente publike është e garantuar edhe me nënparagrafin 3.2, të nenit 17 të ligjit nr. 06/L081, për Qasje në Dokumente Publike, si dhe me nenin 12, 13 dhe 14, të Ligjit nr. 06/L-082, për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Ne si OE ankues, krahas kësaj kërkesë, në të njëjtën kohë do të raportojmë në organe dhe agjencione përkatëse shtetërore për veprime kundërligjore të njëpasnjëshme nga AK në fjalë, për shkelje të parimeve dhe tentativën për keqpërdorim të parasë publike.

- Lidhur me mohimin e qasjes në dokumente publike OSHP, ka nxjerr disa vendime, ku sipas tyre një mohim i tillë është vlerësuar nga OSHP ndryshe nga AK.
- Në ueb faqen e OSHP-së mund t'i referoheni vendimit me nr. 606/23 ; 877/23 e shumë vendimeve të tjera.
- Për mos ofrim të qasjes në dokumente publike edhe Agjencia për Informim dhe Privatesi (tutje: AIP) ka të nxjerra me dhjetra vendime lidhur me këtë çështje, madje të shoqëruara edhe me shqiptim gjobash.
- Në ueb faqen e AIP gjeni shumë vendime, në mesin e tyre vendimet me nr. 770/2024; 875/2024 e shumë të tjerë.

### **Përgjigje në Pretendimi Nr. 3 Ankimor:**

Pretendimi juaj në këtë pikë është i pabazuara;

**Sa i përketet qasjes në Dokumentacionet e kërkuar, ne po ju dërgojmë vetëm e-mail Zyrtar të Komunikimit**

## Kërkesë e dorëzuar nga ana juaj:



Prokurimi Rahovec <prokurimi.rahovec@gmail.com>

### Kërkesë për qasje në dokumente publike

3 messages

N.N.P BG-ING <bging2011@gmail.com>  
To: Prokurimi Rahovec <prokurimi.rahovec@gmail.com>


Tue, Jun 16, 2026 at 3:44 PM

Të nderuar,

Të bashkangjitur gjeni kërkesën për qasje në dokumente publike për procedurën e prokurimit: Rrethimi i oborreve të shkollave, nr.prokurimit: 623-26-2494-5-2-1. Të njëjtën e gjeni të ngarkuar edhe në platformën e-prokurim.

Me respekt/ Kind Regards  
Bajram Gashi  
Owner & Manager  
BG-ING NNP  
Phone: +383(49)356-164  
Email: bging2011@gmail.com  
Address: Dubravë, 23000 Suharekë, Republic of Kosovo

***Built on quality. Trusted for results!***

 Kërkesë për qasje në dokumente publike.pdf  
678K

## Qasje e lejuar nga AK:

Prokurimi Rahovec <prokurimi.rahovec@gmail.com>  
To: "N.N.P BG-ING" <bging2011@gmail.com>

Wed, Jun 17, 2026 at 10:53 AM

Te nderuar,

Për shkak se nuk lejohet përdorimi i USB-së neper Institucionet, ne attachment gjeni te bashkangjitur te tere ofertën e Operatorit Ekonomik te rekomanduar për kontratë dhe Operatorëve tjerë Ekonomik pjesëmarrës, e shkarkuar neper mjet e-prokurimit!

 E tërë oferta - AGE group SH.P.K..zip

 E tërë oferta - BAJRAM HA.GASHI B.I..zip

 E tërë oferta - Eng Bau SH.P.K..zip

 E tërë oferta - N.T.P. Adri Zaun - Rrethoja.zip

 E tërë oferta - NPN EUROING SH.P.K..zip

 E tërë oferta - STONE STRONG SH.P.K..zip

Gmail - Kërkesë për qasje në dokumente publike

<https://mail.google.com/mail/u/0/?ik=dba4bc4051&view=pt&search...>

 E tërë oferta - VALDRINI-A SH.P.K..zip

 E tërë oferta - VED Group SH.P.K..zip

Ju lutem na konfirmoni pranimin e e-mailit!

Me respekt:  
Zyra e Prokurimit Rahovec  
[Quoted text hidden]

## Konfirmimi nga ana juaj për pranimin e dokumentacionit:

N.N.P BG-ING <bging2011@gmail.com>  
To: Prokurimi Rahovec <prokurimi.rahovec@gmail.com>

Wed, Jun 17, 2026 at 2:05 PM

Faleminderit, e kemi pranuar e-mailin.

Me respekt/ Kind Regards  
Bajram Gashi  
Owner & Manager  
BG-ING NNP  
Phone: +383(49)356-164  
Email: bging2011@gmail.com  
Address: Dubravë, 23000 Suharekë, Republic of Kosovo

***Built on quality. Trusted for results!***

[Quoted text hidden]

Nga konstatimet e lartcekur u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

### **KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij **vendimi të AK-së ju munde të paraqitni** ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

### **Vendimi Publikohet:**

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>